



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 nën d) si dhe nenit 40.1 dhe 40.2 nën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ, Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, si dhe nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 nën pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2024 të mbajtur më 26.01.2024 mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratim të Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2024

1. Miratohet Plani i Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e vendimit është Plani i Punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Komunën e Klinës për vitin 2024.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
4. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Zyra e Informimit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-3472/2024
Klinë, më 01.02/2024



Kryesuesi,
Fadil Gashi